



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 18.04.2018

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 15.05.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "VE-MOR" për aktivitetin: "Mirëmbajtja verore e rrugëve dhe trotoareve në qytetin e Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: **616 -18-1347-211** nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "VE-MOR" e datës 15.05.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit " Mirëmbajtja verore e rrugëve dhe trotoareve në qytetin e Prishtinës "" me Nr.616 18 421 211,Nr. Brendshëm 616 18 015 211 kundër *Njoftimit për dhënje të kontratës* te AK –së, të datës 10.05.2018, te publikuar ne web-faqe te KRPP-së.
2. Vërtetohet *Njoftimi për dhënje të kontratës* i publikuar me datë: 14.05.2018;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj me aktivitetin*.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "VEMOR" me datë 15.05.2018 ka parashtruar kërkesën-ankesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja verore e rrugëve dhe trotoareve në qytetin e Prishtinës" me Nr.616 18 421 211 Nr. Brendshëm 616 18 156 211 ". Autoriteti Kontraktues, me datë 17.05.2018, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

1. Pretendimet se i plotëson kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional respektivisht lidhur me dëshmitë e kontratave të realizuara janë të pa bazuara për arsye në vijim:

-Referenca nga Komuna e Pejës në vlerën e pretenduar prej 50.000,00 është lidhur me një kontratë të vitit 2013(që d.t.th.është në kundërshtim me kërkesën e tenderit për shërbimet e kryera në tri vitet e fundit,duke llogaritur nga koha e publikimit te njoftimit për kontratë e qe d.t.th.nga data 02.04.2015-02.04.2018)dhe në referencë nuk ka të cekur asgjë lidhur me përfundimin e saj sipas viteve dhe vlerën e saj;

-Pretendimi për referencat me KFOR-in italian është poashtu e pa bazuar,pasiqë kemi të bëjmë me vetëm një dëshmi në vlerën prej 60,000.00 euro,ndërsa dëshmitë tjera të dorëzuara kanë të bëjnë vetëm me njoftimin mbi përzgjedhjen dhe nuk ka dëshmi për realizim të shërbimeve;

-Pretendimi tjetër për referencën nga Komuna e Gjakovës poashtu është i pa bazuar,pasiqë referenca nga kjo Komunë është konstatim për realizim të një pjese të kontratës në proces(datë 22.09.2016)dhe nuk është dëshmi për përfundimin e kontratës.

Poashtu ju sqarojmë se edhe kontratat tjera që i keni paraqitur në listën e kontratave të realizuara:Mirëmbajtja e hapësirave publike në Komunën e Lipjanit dhe Mirëmbajtja e rrugëve rurale në Komunën e Prishtinës,janë kontrata të pa përfunduara dhe nuk janë të pranueshme,pasiqë në FDT dëshmitë e kërkuara janë si vijon:Lista e projekteve të realizuara në tri vitet e fundit(sipas kërkesës)dëshmuar me kopjet e referencave apo çertifikatave të pranimeve.

Pretendimi numër 2 poashtu është i pa bazuar,pasiqë kushti 3 për trajtimin e tenderit të OE-ik"TOIFOR"si jo normalisht i ulët është i pa qëndrueshëm dhe në vazhdim do ta keni kalkulimin financiar lidhur me këtë:

	kushti 1 - eshte permbushur kushti i pare sepse jane pranuar 7 oferta	Pranuar 7 oferta
--	--	-------------------------

1	191,516.17
2	119,882.99
3	132,374.34
4	245,966.49
5	246,730.53
6	185,515.52
7	217,361.00
total	1,339,347.04
mesatarja	191,335.29
30% i mesatares	57,400.59
pragu 30%	133,934.70
10% ne mes dy ofertave	13,237.43

kushti 2 - te gjitha ofertat nen kete cmim permbushin kushtin e dyte

kushti 3 - oferta me e lire ne krahasim me oferten e dyte me te lire
nuk permbush kushtin e trete

pragu 10%

119,136.91

Kushti	Kerkesa	Arsyetimi
1	jane pranuar me shume se 3 oferta	është plotesuar kushti i pare sepse jane pranuar 7 oferta.
2	çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të mbetur	Oferta e dyte ploteson kushtin e dyte (30%) sepse çmimi i ofruar eshte me shume se 30% me i ulet se mesatarja e tenderve. Shih pragun ne kolonen D14
3	çmimi i ofruar është më pak se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët	Oferta e dyte nuk ploteson edhe kushtin e trete (10%) sepse ne krahasim me oferten e dyte me radhe eshte me pak se 10% me i ulet. Shih pragun D16

Nga tabela shihet se pragu për trajtim të një çmimi jo normalisht i ulët është 119.136.91 €,ndërsa çmimi i tenderuesit për të cilin pretendoni se duhet trajtuar i tillë është 119,882.99 €.

Po ashtu për korektësi ju sqaroj se tenderi juaj nuk do te mund te ishte pjese e kombinimeve fituese edhe sikur te ishte i pergjegjshëm për shkak te çmimve shumë të larta në raport me çmimet e tenderuesëve tjerë.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne sqarimet dhe konstatimet e paraqitura më lartë ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit